



Vlerësimi Pedagogjik

i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore

Udhëzues praktik

Botimi i këtij doracaku është bërë në kuadër të projektit: *“Asgjë për ne pa zërin tonë”* që **Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar** e implementon me mbështetje financiare nga Zyra e **“Save the Children” Kosova**. Doracaku është përgatitur me kërkesën dhe në bashkëpunim me **Divizionin e Arsimit Gjithëpërfshirës të MASHTI**. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi/t i/e saj. Qeveria suedeze apo “Save the Children” jo domosdoshmërisht ndajnë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë publikim.



Save the Children

Kontribuuesit në hartimin e Udhëzuesit për Vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore:

1. Luljeta Kabashi, zv udhëheqëse e Divizionit të arsimit gjithëpërfshirës, MASHTI
2. Elhame Llapashtica, zyrtare e lartë nga MASHTI
3. Vjollca Osmani, mësimdhënëse udhëtuese, QBMK “Nëna Terezë”, Mitrovicë
4. Burim Sylejmani, mësimdhënës mbështetës, SHFMU “Ahmet Hoxha” Ferizaj
5. Liridona Kosumi, zyrtare për arsim gjithëpërfshirës, Komuna e Gjilanit
6. Vullnet Ramadani, mësimdhënës udhëtues, QBMK “Lef Nosi” Prizren
7. Rukije Gashi, përfaqësuese nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve
8. Myrvete Morina, lektore në MASHTI

Hyrje

Ky udhëzues synon t'u shërbejë ekipeve vlerësuese që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë. Udhëzuesi trajton rëndësinë e vlerësimit të saktë dhe të përshtatshëm, strukturën dhe funksionimin e ekipit vlerësues komunal, procedurat e vlerësimit, identifikimin e nevojave specifike të fëmijës dhe rekomandimet për shkollën, mësuesit dhe familjen.

Vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta është një proces i strukturuar dhe i domosdoshëm, që synon identifikimin e nevojave arsimore, aftësive dhe potencialit të fëmijëve, si dhe ofrimin e mbështetjes për të siguruar mundësi të barabarta në arsim. Ky proces realizohet nga një ekip vlerësues komunal për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, i cili përfshin profesionistë të ndryshëm, si: pedagogu special, psikologu shkollor, logopedi, punonjësi social dhe profesionistë të tjerë sipas nevojës.

Në proces, ekipi mund të përballlet me disa vështirësi specifike, të cilat shpesh varen nga situata e fëmijës dhe mjedisi ku ndodh vlerësimi. Këto vështirësi mund të përfshijnë: mbledhjen e informacionit të saktë dhe gjithëpërfshirës, komunikimin dhe bashkëpunimin me prindërit, mësimdhënësit për mbledhje të informacionit të saktë, vlerësimin e gjendjes emocionale dhe sociale të fëmijës, identifikimin e nevojave të veçanta pedagogjike, përdorimin e metodologjive të përshtatshme për vlerësim, përshtatjen në kohën e duhur si dhe konkludimin, përpilimin e rekomandimeve dhe zbatimin tyre.

Zgjidhja e këtyre vështirësive kërkon një qasje të integruar dhe të individualizuar, si dhe mbështetje nga institucionet arsimore dhe shëndetësore për të siguruar një vlerësim sa më të drejtë dhe të dobishëm për fëmijën.

Procesi i vlerësimit të fëmijës bazohet në UA nr. 16/2017 Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe UA nr. 02/2024 për ndryshim dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ nr. 16/2017. Vlerësimi ka për qëllim të sigurojë një kuptim gjithëpërfshirës dhe të detajuar mbi nevojat individuale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Ky proces përfshin vlerësimin e aftësive zhvillimore, arsimore, shëndetësore dhe sociale të fëmijës, duke identifikuar pikat e forta dhe sfidat me të cilat ai ose ajo mund të përballlet në mjedisin arsimor dhe social.

Informacioni i mbledhur gjatë këtij procesi është themelor për krijimin e Planit Individual Arsimor (PIA), i cili synon të përshtatë mësimdhënien dhe mbështetjen sipas nevojave specifike të fëmijës. PIA ndihmon në përmirësimin e përvojës arsimore të fëmijës duke përfshirë strategji të personalizuar, objektiva të qarta dhe ndërhyrje të përshtatshme që mundësojnë zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës.

Gjithashtu, ky proces nxit bashkëpunimin ndërmjet familjes, mësuesve dhe profesionistëve të tjerë për të krijuar një mjedis të harmonizuar dhe mbështetës, që siguron mundësi të barabarta për arsimim dhe zhvillim.

Vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të jetë në bashkëpunim të ngushtë me familjen e fëmijës. Angazhimi i familjes është shumë i rëndësishëm për të siguruar që nevojat e fëmijës të merren parasysh dhe që të krijohen mundësi të qëndrueshme dhe të përshtatura për zhvillimin e tij/saj.

Vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF-FR) synon të ofrojë një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të standardizuar për të vlerësuar nevojat dhe mundësitë zhvillimore të këtyre fëmijëve. Ky model vlerësimi bazohet në parime shkencore dhe pedagogjike që ndihmojnë në identifikimin e barrierave dhe lehtësuesve, që ndikojnë në përfshirjen dhe funksionimin e fëmijës në mjediset arsimore dhe sociale.

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF-FR) është një udhërrëfyes i hartuar për profesionistët që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta, duke përfshirë mësues, psikologë, pedagogë specialë, logopedë dhe punonjës socialë. Ai ndihmon në sigurimin e një analize të detajuar dhe holistike të faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe mjedisorë që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës.

Përmes këtij dokumenti, synohet të promovohet barazia në mundësi dhe ofrimi i mbështetjes profesionale, duke u siguruar që fëmijët të marrin ndihmën e nevojshme për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë dhe për të kontribuar në një mjedis gjithëpërfshirës e të drejtë. KNF-FR shërben gjithashtu si një platformë për planifikimin e ndërhyrjeve efektive, përcaktimin e objektivave arsimore dhe ndihmën në krijimin e Planeve Individuale Arsimore (PIA).

Drejtoria Komonale të Arsimit, mbajnë përgjegjësi ligjore për themelimin dhe funksionalizimin e Ekipeve Komonale për Vlerësim Pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Përmes zyrtarëve për arsim gjithëpërfshirës, ato promovojnë punën e këtij ekipi dhe sigurojnë mbështetje në procesin e vlerësimit. Zyrtari gjithëpërfshirës, pranon kërkesat për vlerësim, përcjell rekomandimet e Ekipit Vlerësues së bashku me formularët e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit (KNF) dhe monitoron zbatimin e tyre për të siguruar që fëmijët të marrin mbështetjen e duhur.

Për më tepër, drejtori komunal i arsimit, duke u bazuar në rekomandimet e Ekipit Vlerësues Komunal, merr vendimin përkatës që fëmija ka nevoja të veçanta arsimore, duke siguruar kështu një qasje të përshtatshme dhe të koordinuar për trajtimin e nevojave të tij arsimore dhe zhvillimore. Ky proces siguron që çdo fëmijë të trajtohet në mënyrë individuale dhe të ketë mundësi të barabarta për arsimim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Arsimi gjithëpërfshirës

Arsimi gjithëpërfshirës është një qasje bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse ndaj edukimit, që synon t'i ofrojë çdo fëmijë mundësinë për të mësuar dhe për t'u zhvilluar në një mjedis të barabartë dhe përfshirës. Kjo qasje bazohet në parimin se arsimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe duhet të jetë i qasshëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësitë, gjinia, prejardhja kulturore, sociale apo ekonomike.

Arsimi gjithëpërfshirës është i garantuar sipas Ligjit të Arsimit Parauniversitar, në nenet 39, 40, 41, 42 dhe 43, të cilat trajtojnë arsimin e të gjithëve, parimin e gjithëpërfshirjes, dhe vlerësimin e përshtatshëm për të gjithë fëmijët, pa dallime. Ky ligj, thekson rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, duke siguruar që ata të kenë mbështetje të nevojshme për zhvillimin e aftësive dhe integrimin në shoqëri. Gjithashtu, Udhëzimi administrativ nr. 16/2017 për Vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij nëpërmjet Udhëzimit administrativ nr. 02/2024), kanë për qëllim rregullimin dhe standardizimin e praktikave të vlerësimit për këta fëmijë, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësinë të përfitojë një vlerësim të drejtë dhe të përshtatshëm për nevojat e tij arsimore.

Një nga dokumentet ndërkombëtare më të rëndësishme është *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (1989)*, ku theksohet se të gjithë fëmijët, pa dallim race, ngjyre, feje, seksi, aftësish apo ndonjë

status tjetër, duhet të kenë mundësi për zhvillim të plotë dhe të barabartë. Sipas kësaj konvente, shtetet e angazhuara duhet të sigurojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë mundësi për t'u arsimuar në mënyrë të barabartë dhe të përfshihen në shoqëri, duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe mundësi të barabarta për mësim.

Roli i ekipit komunal në promovimin e gjithëpërfshirjes në arsim është thelbësor për sigurimin e mundësive të barabarta për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Ky ekip ka përgjegjësinë të zhvillojë dhe zbatojë strategji që përfshijnë të gjithë fëmijët, duke krijuar mjedise arsimore që respektojnë dhe mbështesin diversitetin e nevojave të nxënësve.

Arsimi gjithëpërfshirës nuk është vetëm përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta, por edhe krijimi i një kulture edukative që respekton dhe vlerëson dallimet individuale. Ai kërkon bashkëpunim mes mësuesve, prindërve dhe komunitetit për të siguruar që të gjithë nxënësit të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Nëpërmjet arsimit gjithëpërfshirës, shoqëria synon të ndërtojë një të ardhme më të drejtë dhe më të barabartë, ku të gjithë individët të kenë mundësinë për të kontribuar në zhvillimin personal dhe atë kolektiv.

Roli i mësimdhënësit dhe kujdestarit të klasës në procesin e identifikimit dhe referimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore

Mësimdhënësi dhe kujdestari i klasës kanë një funksion thelbësor në procesin e identifikimit të hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, përmes një qasjeje të strukturuar dhe bashkëpunuese ndërmjet institucionit edukativo-arsimor, familjes dhe strukturave kompetente komunale.

Në kuadër të përgjegjësive profesionale, mësimdhënësi/kujdestari i klasës realizon vëzhgim të përditshëm dhe sistematik të zhvillimit akademik, social, emocional dhe të sjelljes së nxënësit në mjedisin mësimor. Ky proces i vëzhgimit dokumentohet përmes plotësimit të instrumentit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionalitetit (KNF), duke respektuar udhëzimet administrative në fuqi, sipas të cilave monitorimi duhet të zgjasë për një periudhë të pandërprerë prej tre muajsh. Në rast se gjatë kësaj periudhe identifikohen vështirësi të vazhdueshme, mësimdhënësi/kujdestari i klasës ka për detyrë të njoftojë prindin apo kujdestarin ligjor të fëmijës mbi vëzhgimet e bëra dhe

të diskutojë nevojën për një vlerësim më të thelluar. Me marrjen e pëlqimit të shkruar nga prindi, procedohet me përgatitjen e dokumentacionit për referim.

Mësimdhënësi/kujdestari i klasës përgatit një raport gjithëpërfshirës mbi ecurinë dhe vështirësitë e identifikuar, dhe ia dorëzon atë drejtorit të institucionit edukativo-arsimor për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm.

Drejtori i institucionit, në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, informon zyrtarisht Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe kërkon realizimin e vlerësimit pedagogjik të nxënësit nga ekipi komunal për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Ky proces garanton që fëmijët me vështirësi të identifikohen dhe mbështeten në kohë, në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes, të barazisë në arsim dhe të të drejtave të fëmijës për zhvillim të plotë individual në një mjedis mbështetës dhe të përshtatshëm.

Procesi i Vlerësimit

Ky udhëzues është hartuar në përputhje me Udhëzimin administrativ nr. 16/2027 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, i cili përcakton strukturën, rolin dhe përgjegjësitë e ekipit komunal për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Në kontekstin e zbatimit të politikave të arsimit gjithëpërfshirës, funksionimi efikas dhe profesional i këtij ekipi paraqet një mekanizëm kyç për të garantuar vlerësim të drejtë, të dokumentuar dhe në kohë për fëmijët që shfaqin vështirësi në zhvillim apo në procesin mësimor.

Ekipi vlerësues pedagogjik komunal luan një rol thelbësor në sigurimin e mbështetjes së personalizuar për çdo fëmijë, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet arsimore, prindërit dhe akterët tjerë relevantë, në mënyrë që të sigurohet qasje e barabartë në arsim dhe të promovohet zhvillimi i plotë i potencialit të fëmijës. Udhëzuesi ofron udhëzime praktike dhe profesionale për anëtarët e ekipit, në pajtim të plotë me kornizën ligjore, duke shërbyer si një burim referimi në ushtrimin e përditshëm të detyrave vlerësuese dhe mbështetëse.

Kompetencat e ekipit komunal të vlerësimit pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore janë:

Vlerësimi pedagogjik për pjesëmarrjen dhe performancën e fëmijës në procesin arsimor bazuar në nevojat individuale të nxënësit:

Ekipi komunal për vlerësim pedagogjik, në përputhje me Udhëzimin administrativ nr. 16/2027 të MASHTI, ka kompetencë të kryejë vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, me qëllim të identifikimit të vështirësive dhe përcaktimit të mbështetjes së përshtatshme arsimore për secilin fëmijë.

Ky vlerësim është i bazuar në të dhënat e mbledhura përmes formularit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionalitetit (KNF), i cili plotësohet nga mësimmshënësi/kujdestari i klasës, dhe fokusohet në këto komponentë kyç:

Pjesëmarrja aktive në aktivitetet mësimore: Analizohet niveli i përfshirjes së nxënësit në aktivitetet e përditshme mësimore – përfshirë aktivitetet praktike dhe detyrat mësimore – duke marrë parasysh nevojat individuale, mënyrat alternative të komunikimit dhe shkallën e vështirësive që fëmija mund të përjetojë gjatë përfshirjes. Pjesëmarrja nuk vlerësohet në mënyrë standarde, por në raport me rrethanat dhe aftësitë konkrete të fëmijës në kontekstin e mësimmshënies bashkëkohore.

Performanca akademike: Vlerësohet mënyra se si fëmija përvetëson njohuritë dhe kompetencat në përmbajtjet kurrikulare, me fokus në rezultatet dhe përmbushjen e objektivave mësimore në lëndët themelore. Vlerësimi është i individualizuar dhe merr parasysh ritmin dhe stilin e të nxënit të fëmijës.

Përshtatja e mësimmshënies: Vlerësohet nëse mësimmshënësia dhe aktivitetet janë përshtatur sipas nevojave të fëmijës, përfshirë metodologjitë e përdorura dhe mjetet ndihmëse që kontribuojnë në mësimin efektiv.

Zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale: Ky aspekt përfshin vlerësimin e aftësisë së fëmijës për të ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe të qëndrueshme me bashkëmoshatarët, mësimmshënësit dhe figurat tjera mbështetëse, si dhe aftësinë për të bashkëpunuar dhe për të respektuar rregullat sociale në mjedisin shkollor dhe përtej tij.

Vlerësimi përqendrohet në identifikimin e mënyrës se si fëmija reagon emocionalisht ndaj situatave të ndryshme, përfshirë stresin, frustrimin, ndryshimet apo sfidat në mësim. Gjithashtu, vlerësohet niveli i vetëdijes emocionale (si fëmija i njeh dhe i emërton emocionet e veta), aftësia për të menaxhuar ndjenjat dhe strategjitë që përdor për vetërregullim.

Komunikimi me prindërit dhe profesionistët: Vlerësimi pedagogjik realizohet në bashkëpunim të ngushtë me prindërit e fëmijës dhe profesionistët përkatës (psikologë, pedagogë, punonjës socialë, etj.), në mënyrë që të sigurohet një kuptim i plotë dhe gjithëpërfshirës i situatës së fëmijës. Ky bashkëpunim ndihmon në përcaktimin e formave më të përshtatshme të mbështetjes dhe në hartimin e Planit Individual të Arsimit, nëse është e nevojshme.

Shërbimet e mbështetjes

Shërbimet e mbështetjes janë një komponent thelbësor në procesin arsimor, veçanërisht kur synohet përmbushja e nevojave individuale të nxënësve. Këto shërbime përfshijnë një gamë të gjerë ndërhyrjesh dhe mbështetjesh që synojnë të sigurojnë mësimdhënie efektive dhe përfshirje maksimale në procesin arsimor.

Më poshtë janë disa prej shërbimeve kryesore të mbështetjes:

1. Mbështetje pedagogjike

Planifikimi Individual:

Rekomandimi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) bazuar në vlerësimin e nevojave specifike të nxënësit.

Mbështetja në procesin mësimor:

Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore përfitojnë mbështetje të drejtpërdrejtë gjatë orëve mësimore, përmes sqarimeve shtesë, ushtrimeve të përshtatura, apo mësimi plotësues individual ose në grup të vogël. Kjo mbështetje mund të ofrohet nga mësimdhënësi klasor/lëndor ose mësimdhënësi mbështetës, në përputhje me objektivat e përcaktuara në PIA.

Strategjitë e mësimdhënies së diferencuar:

Mësimdhënësit zbatojnë metodologji dhe metoda të diferencuara të të nxënës dhe mësimdhënies, duke përshtatur përmbajtjen, mënyrën e punës dhe format e vlerësimit sipas stilit të të nxënës dhe aftësive të nxënësit. Kjo përfshin përdorimin e mjeteve të ndryshme didaktike, teknologjisë mbështetëse dhe aktiviteteve fleksibile, që i mundësojnë çdo nxënës përfshirje aktive dhe të barabartë në procesin mësimor.

2. Mbështetje psikologjike dhe sociale

Mbështetja psikologjike dhe sociale përbën një komponent të rëndësishëm vlerësues, që realizohet nga psikologu dhe punonjësi social, si pjesë e ekipit vlerësues në nivel komunal ose shkollor.

Këta profesionistë, në bashkëpunim me anëtarët tjerë të ekipit (mësimdhënësit, pedagog, prind, etj.) vlerësojnë aspekte që lidhen me:

- zhvillimin emocional dhe mirëqenien psikologjike të fëmijës,
- aftësitë sociale dhe ndërveprimin me të tjerët,
- përfshirjen në mjedisin shkollor dhe ndikimin e faktorëve socialë dhe familjarë.

Ky vlerësim ndihmon në identifikimin e vështirësive të mundshme në fushën emocionale dhe sociale, si dhe në përcaktimin nëse fëmija ka nevoja të veçanta arsimore.

3. Mbështetje personale për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Në kuadër të vlerësimit pedagogjik, një ndër kompetencat e ekipit komunal për vlerësim, sipas Udhëzimit administrativ për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, është vlerësimi i nevojës për mbështetje personale për fëmijën në mjedisin shkollor.

Ekipi vlerësues, në bazë të të dhënave nga vëzhgimi, dokumentacioni dhe rekomandimet mjekësore, bashkëbisedimet me prindin dhe mësimdhënësit, përcakton nëse fëmija ka nevojë për asistent personal në mënyrë që të sigurohet përfshirja dhe funksionimi i tij i pavarur në aktivitetet e përditshme shkollore.

Këto shërbime të mbështetjes janë të dizajnuara për të siguruar që çdo nxënës të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për të përparuar dhe për të arritur suksesin personal dhe akademik.

Mësimdhënia e individualizuar dhe kurrikula

Plani Individual i Arsimit (PIA) është një dokument funksional dhe praktik që ndihmon në zbatimin e kurrikulës në mënyrë të përshtatur dhe të personalizuar, në përputhje me nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Ai hartohet nga ekipi në nivel shkolle dhe shërben si bazë për planifikimin, organizimin dhe vlerësimin e procesit të të nxënësve për nxënësin.

PIA ndërlidhet ngushtë me kurrikulën e përgjithshme, duke siguruar:

- përcaktimin e qëllimeve afatshkurtra dhe afatgjata për të nxënësit,
- planifikimin e mbështetjes së nevojshme dhe strategjive të përshtatura të mësimdhënies,
- përcaktimin e rezultateve individuale të të nxënësit, kur nxënësi nuk mund t'i arrijë ato që parashihen në kurrikulën standarde,
- mënyrën e vlerësimit të individualizuar, bazuar në qëllimet e përcaktuara në PIA.

Qëllimi parësor i PIA-s është të sigurojë që fëmija:

- të përfitojë maksimalisht nga mësimi, në përputhje me mundësitë dhe potencialin e tij/saj,
- dhe të ndjekë kurrikulën e rregullt për aq sa është e mundur.

Në ato raste kur vlerësohet se nxënësi ka vështirësi të theksuara në ndonjë lëndë mësimore apo fushë, përmbajtja e lëndës mund të individualizohet, duke përcaktuar rezultate të veçanta për të. Ndërkohë, në lëndët ku nxënësi ka aftësi për të ndjekur programin standard, nuk ka nevojë për përshtatje, dhe ai/ajo ndjek kurrikulën si bashkëmoshatarët.

Në këtë mënyrë, PIA shërben si mjet për zbatim të mësimdhënies së individualizuar brenda kurrikulës së përbashkët, duke e bërë arsimin gjithëpërfshirës më efektiv dhe të drejtë për të gjithë nxënësit.

Shërbimet rehabilituese

Shërbimet rehabilituese janë mbështetje të specializuara që ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë, rikuperojnë ose përmirësojnë aftësitë e tyre fizike, psikologjike, sociale dhe akademike. Të domosdoshme për nxënësit me nevoja të veçanta, këto shërbime përdorin qasje multidisiplinare dhe teknologji për të siguruar përfshirje dhe sukses të plotë.

Disa nga ndërhyrjet kryesore rehabilituese përfshijnë *fizioterapinë, logopedinë, rehabilitimin psikologjik, kognitiv, edukativ dhe social*.

Pajisjet dhe instrumentet e nevojshme ndihëmse:

Pajisjet dhe instrumentet e nevojshme janë mjete mbështetëse që ndihmojnë nxënësit me nevoja të veçanta në procesin arsimor, rehabilitues dhe në jetën e përditshme. Përdorimi i tyre synon të sigurojë qasje të barabartë në arsim, të përmirësojë aftësitë e tyre dhe të nxisë pavarësinë.

Më poshtë janë kategoritë dhe shembujt kryesorë të pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme:

Pajisjet për mobilitet dhe lëvizshmëri

Këto mjete ndihmojnë nxënësit me kufizime fizike të lëvizin dhe të marrin pjesë në aktivitete:

Karroca me rrota: Manuale ose elektrike për lëvizje të pavarur.

Paterica: Për mbështetje në ecje.

Pajisjet për përmirësimin e aftësive shkollore

Mjetet e dizajnuara për të ndihmuar nxënësit të mësojnë dhe të përfshihen në procesin arsimor:

Tabela interaktive: Për mësim gjithëpërfshirës dhe vizuale.

Kompjuterë dhe tableta: Me aplikacione edukative dhe ndihmëse për të nxënit.

Pajisje për shkrim dhe lexim: Llupa elektronike, libra audio, tastiera të përshtatura për nxënësit me vështirësi vizuale ose motorike.

Mjete ergonomike: P.sh., lapsa me kapëse speciale ose fletore me linja të trasha për nxënësit që kanë vështirësi në të shkruar.

Pajisjet për rehabilitim fizik

Përdoren për të përmirësuar aftësitë motorike dhe për të ndihmuar në rikuperim:

Pajisje për ushtrime fizike: Topa terapie, rripa rezistence dhe mjete për përmirësimin e koordinimit.

Mjete për ndihmën e ekuilibrit: Dërrasa ekuilibri ose platforma terapie.

Shtrat terapie dhe pajisje për ushtrime: Për përdorim në seanca fizioterapie.

Pajisjet dhe mjetet për ndihmë në jetën e përditshme

Këto mjete ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi të pavarura në përditshmëri:

Pajisje për ushqyerje: Lugë dhe gota ergonomike për nxënësit me kufizime motorike.

Pajisje për veshje: Ndhmues për lidhjen e këpucëve ose veshjen e rrobave.

Alarme vizuale ose vibruese: Për nxënësit me vështirësi dëgjimi.

Softuerë dhe teknologji edukative

Programe për përmirësimin e leximit dhe shkrimit: Softuerë si "Text-to-Speech" ose "Speech-to-Text".

Aplikacione për menaxhimin e kohës: Për të ndihmuar nxënësit me çrregullime të përqendrimit.

Platforma të personalizuar mësimore: Për ofrimin e materialeve të përshtatura për nevojat individuale.

Pajisje të specializuara për shikim dhe dëgjim

Pajisje për nxënësit me vështirësi në shikim ose dëgjim:

Aparate dëgjimi dhe sisteme FM: Për të përmirësuar dëgjimin.

Llupa dhe teleskop optik: Për nxënësit me dëmtime vizuale.

Pajisje braille: Makina shkrimi braille ose pajisje elektronike për përkthimin e teksteve në braille.

Transporti i përshtatshëm

Transporti i përshtatshëm është një shërbim thelbësor për nxënësit me nevoja të veçanta, duke siguruar që ata të kenë qasje të sigurt, të rehatshme dhe të barabartë në institucionet arsimore dhe aktivitetet jashtëshkollore. Ky transport është i dizajnuar për të përmbushur nevojat specifike të individëve dhe për të adresuar kufizimet e tyre fizike, shqisore dhe njohëse.

Karakteristikat e Transportit të Përshtatshëm

1. Qasja (aksesueshmëria)

- Rampa ose ashensorë për karrocën me rrota.
- Dyer dhe hapësira të mjaftueshme për të akomoduar pajisje ndihmëse.
- Mbajtëse sigurie për karrocën me rrota.

2. Siguria

- Sisteme të posaçme të sigurisë për ulëset dhe pajisjet ndihmëse.
- Pajisje për monitorim (kamera ose sensorë sigurie).
- Trajnim i shoferëve dhe ndihmësve për menaxhimin e situatave emergjente dhe mbështetjen e nxënësve.

3. Përshtatja për nevojat individuale

- Ulëse të rehatshme dhe të përshtatura për nxënësit me kufizime fizike.
- Pajisje ndihmëse si kufje për anulimin e zhurmave ose sinjalizues vizuelë për nxënësit me vështirësi dëgjimi ose shikimi.

4. Mbështetja shtesë

- Prania e një asistenti ose kujdestari për të ndihmuar gjatë transportit.
- Pajisje ndihmëse për nevoja mjekësore emergjente (p.sh., inhalatorë, ndihma e parë).

Llojet e shërbimeve të Transportit të përshtatshëm

1. Autobusë të përshtatur

- Autobusë me rampa ose ashensorë për nxënësit që përdorin karroca me rrota.
- Hapësira të dedikuara për pajisje ndihmëse.

2. Furgonë ose automjete individuale

- Automjete më të vogla për transportin e nxënësve që kërkojnë kujdes më të personalizuar.
- Automjete të pajisura me mjete ndihmëse dhe siguri të lartë.

3. Shërbime të specializuara për transport individual

- Automjete të dedikuara për nxënësit me kushte të rënda shëndetësore që kërkojnë mbështetje mjekësore gjatë udhëtimit.

4. Transporti publik i përshtatur

- Autobusë publik me qasje për karroca me rrota dhe sisteme ndihmëse për orientimin e personave me aftësi të kufizuara (sistem audio dhe vizual).

Përfitimet e transportit të përshtatshëm

- **Barazia në arsim:** Siguron që të gjithë nxënësit të kenë qasje të barabartë në shkollë dhe aktivitete.
- **Siguria dhe rehatia:** Ndhmon në transportin e sigurt dhe pa stres për nxënësit dhe familjet e tyre.
- **Pavarësia:** Nxit pavarësinë e nxënësve duke i ndihmuar ata të udhëtojnë në mënyrë të përshtatshme për nevojat e tyre.
- **Mbështetje sociale:** Ndhmon nxënësit të marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore.

Ekipi komunal për vlerësim pedagogjik gjithashtu përcakton institucionin arsimor në të cilin fëmija do të vijojë edukimin dhe arsimin.

Institucion
parashkollor

Shkollë fillore dhe
e mesme e ulët

Shkolle e mesme
e lartë

Qendër Burimore
sipas profileve

Përbërja e Ekipit vlerësues pedagogjik në komunë

Ekipit vlerësues pedagogjik përbëhet nga katër anëtarë të përhershëm dhe zëvendësuesit e tyre me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje:



Pedagogu special,
kryetar komisioni



Psikologu shkollor



Logopedi



Punëtori Social

Specialistë të fushave të tjera mund të ftohen sipas nevojës dhe në raste kur fëmija ose prindi janë të shurdhër, kërkohet interpretim në gjuhën e shenjave (UA 02/2024 neni 3 pika 1).

Kryetari i ekipit vlerësues mund të ftojë në takim personat të cilët ndihmojnë procesin e vlerësimit sipas specifikave p.sh asistente të gjuhës së shenjave dhe të tjerë.

Përgjegjësitë e anëtarëve të komisionit

Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit vlerësues pedagogjik janë të fokusuara në vlerësimin dhe mbështetjen e nxënësve, duke siguruar që ata të marrin shërbimet dhe mbështetjen e nevojshme.

Zyrtari komunal për arsim gjithëpërfshirës

- **Udhëheqja e procesit administrativ** për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.
- **Informimi i shkollave** për procesin e vlerësimit dhe dërgon instrumentet e vlerësimit sipas KNF-së.
- **Pranimi i kërkesave** nga personat që e iniciojnë rastin sipas Udhëzimit administrativ, krijon listën e prioritetit, njofton ekipin vlerësues për kërkesat, si dhe pas vlerësimit dërgon në shkollë vendimin që fëmija ka nevoja të veçanta arsimore bashkë me instrumentet përcjellëse me rekomandime.
- **Monitorimi i procesit** të zbatimit të rekomandimeve nga Ekipi vlerësues për interesin më të mirë të fëmijës.
- **Rishikimi i rregullt i rekomandimeve** për të siguruar që nevojat e fëmijës po plotësohen dhe rezultatet po arrihen.
- **Propozimi i ndryshimeve** kur është e nevojshme, bazuar në progresin e fëmijës ose ndryshimet në rrethanat e tij.
- **Sigurimi që procesi i vlerësimit dhe rekomandimet** e bëra janë në përputhje me ligjet dhe politikat shtetërore dhe lokale për edukimin dhe mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Kryetari i Ekipit Vlerësues Pedagogjik në Komunë

Kryetari i ekipit vlerësues pedagogjik në nivel komunal është Pedagogu Special dhe luan një rol kyç në procesin e identifikimit, vlerësimit dhe mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore brenda komunitetit lokal.

Koordinimi i ekipit vlerësues:

- **Organizimi dhe drejtimi i takimeve të ekipit** që përbëhet nga profesionistë sipas Udhëzimit administrativ.
- **Sigurimi që të gjithë anëtarët e ekipit të kontribuojnë** me ekspertizën e tyre në mënyrë efektive.
- **Ndërtimi i mirëkuptimit të përbashkët** brenda ekipit vlerësues, organizimi i procesit të vlerësimit.
- **Planifikimi** i hapave për identifikimin e nevojave të fëmijës.
- **Mbikëqyrja** e mbledhjes së të dhënave të plotësuara në instrument vlerësues.
- **Sigurimi** i përdorimit të instrumenteve dhe metodave të sakta dhe të përshtatshme për vlerësimin.
- **Mbështetja** e vendimmarrjes.
- **Analizimi i informacionit** të mbledhur për të identifikuar nevojat specifike të fëmijës.
- **Komunikimi** me palët e interesuara.
- **Sigurimi që familja e fëmijës të jetë pjesë aktive** e procesit të vlerësimit dhe të informohet plotësisht për çdo hap.

Pedagogu special në Ekipin e vlerësimit pedagogjik në Komunë

Pedagogu special është një nga profesionistët kyç në ekipin vlerësues për fëmijët me nevoja të veçanta, duke sjellë ekspertizë në identifikimin dhe adresimin e vështirësive arsimore dhe zhvillimore të fëmijëve. Ai luan një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e strategjive për mbështetjen e fëmijëve, si në arsim ashtu edhe në jetën e përditshme.

Përgjegjësitë e tij përfshijnë:

Vlerësimi i nivelit të zhvillimit:

Vlerëson zhvillimin njohës, akademik dhe social të fëmijës, duke identifikuar sfidat specifike në të nxënit, si problemet në lexim, shkrim, matematikë ose përqendrim.

Përdorimi i metodave të përshtatura të vlerësimit:

Përdor metoda dhe mjete specifike për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, të cilat janë të përshtatura për nevojat e tyre individuale.

Propozimi i metodave dhe materialeve të përshtatshme të mësimdhënies:

Propozon metoda mësimdhënieje dhe materiale didaktike të përshtatura për nevojat e fëmijëve, si dhe sugjeron teknika që përputhen me stilin e të nxënës të fëmijës.

Krijimi i mjedisit mbështetës:

Rekomandon krijimin e një mjedisi mbështetës në klasë dhe gjatë aktiviteteve të tjera, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e aftësive sociale dhe arsimore të fëmijëve.

Rekomandimet për mbështetje të mëtejshme:

Jep rekomandime për prodhimin e materialeve specifike për nxënësit me vështirësi në mësimnxënie.

Përdorimi i teknologjisë asistive (ndihmëse):

Rekomandon përdorimin e teknologjisë asistive/ndihmëse për të përmirësuar përvojën e të nxënës dhe për të rritur pavarësinë e fëmijëve.

Psikologu në Ekipin Vlerësues Pedagogjik në Komunë

Psikologu ka një rol kyç në Ekipin Vlerësues për Fëmijët me Nevoja të Veçanta, duke ofruar ekspertizë të specializuar në vlerësimin e zhvillimit socio-emocional, njohës dhe të sjelljes së fëmijës. Përgjegjësitë e tij përfshijnë:

1. Vlerësimi psikologjik dhe zhvillimor:

- Identifikon aftësitë njohëse, emocionet, personalitetin dhe sjelljen e fëmijës.
- Identifikon shenjat e çrregullimeve të mundshme, si disleksi, diskalkuli, çrregullimet e spektrit autik (ASD), ADHD, ankthin ose depresionin.
- Rekomandon referim për diagnostikim të mëtejshëm.

2. Analiza e zhvillimit social dhe aftësive ndërpersonale:

- Analizon nivelin e zhvillimit social dhe aftësitë ndërpersonale të fëmijës për të kuptuar më mirë se si ai ndërvepron me të tjerët.

3. Hartimi i rekomandimeve dhe strategjive:

- Harton rekomandime dhe sugjeron strategji për përmirësimin e të nxënës, sjelljes dhe zhvillimit emocional të fëmijës.

4. Këshilla për prindërit:

- Sugjerime për zhvillimin e aftësive emocionale, sociale apo njohëse të fëmijës në shtëpi.

- Rekomandime për rutina, komunikim, aktivitete ose mënyra për të përkrahur fëmijën në mënyrë të përshtatshme emocionale.

Logopedi në Ekipin e Vlerësimit Pedagogjik në Komunë

Logopedi luan një rol të rëndësishëm në Ekipin e Vlerësimit Pedagogjik, duke ofruar ekspertizë në vlerësimin dhe mbështetjen e zhvillimit të aftësive gjuhësore dhe të folurit të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet se jo të gjithë fëmijët kanë nevojë për terapist të folurit, dhe vetë ky fakt ndihmon për të qartësuar rolin profesional të terapistit të folurit në mënyrë më të saktë.

Përgjegjësitë e logopedit përfshijnë:

1. Vlerësimi i nevojave për çrregullime të folurit dhe gjuhës:

- Vlerëson çrregullimet e mundshme të folurit dhe të gjuhës te fëmijët.
- Analizon fjalorin e fëmijës dhe përdorimin e tij të fjalëve me domethënie abstrakte.

2. Vlerësimi i aftësive gjuhësore:

- Vlerëson aftësinë për të nyjtuar tingujt në gjuhën amtare dhe njohjen e rimës në fjalë.
- Analizon aftësinë e fëmijës për të njohur dhe përdorur kohët (e kaluar, tashme, ardhme) në fjali.

3. Analiza dhe sinteza e folurit në fjali:

- Vlerëson aftësinë për të analizuar dhe sintetizuar folurin në nivelin e fjalive, për të kuptuar strukturat gramatikore dhe për të përmirësuar aftësitë e komunikimit.

4. Plani për mbështetje në zhvillimin e aftësive komunikuese:

- Harton një plan mbështetjeje për zhvillimin e aftësive komunikuese të fëmijës, për të përmirësuar aftësinë e tij për të komunikuar në mënyrë të qartë dhe efektive.

Punëtori social në Ekipin e Vlerësimit Pedagogjik në Komunë

Punonjësi social ka një rol kyç në vlerësimin e situatës familjare dhe sociale të fëmijës, duke përdorur disa teknika për të mbledhur informacione të plota dhe të sakta që lidhen me mirëqenien e tij/saj. Ja disa nga teknikat që përdoren për këtë qëllim:

1. Përpilimi i Historisë Familjare dhe Shoqërore:

- Punonjësi social mbledh informacione mbi historinë e familjes, duke përfshirë situatat e mëparshme që kanë ndikuar në zhvillimin e fëmijës.
- Kjo histori përfshin aspekte të rëndësishme si arsimimi, punësimi, shëndeti dhe statusi social i anëtarëve të familjes.

2. Vlerësimi i Mundësive të Familjes:

- Analizohet statusi ekonomik i familjes dhe mundësitë për të ofruar mbështetje për fëmijën.
- Vlerësohen mundësitë për trajtim shëndetësor, edukim dhe shërbime të tjera të nevojshme.

3. Vlerësimi i Statusit Social dhe Dinamikës Familjare:

- Vlerësohet statusi social i anëtarëve të familjes dhe ndikimi i tij te fëmija.
- Analizohet dinamika brenda familjes, si komunikimi, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe mundësia për të siguruar mbështetje emocionale dhe sociale.

4. Vlerësimi i mbështetjes psiko-sociale dhe rrethanave lehtësuese apo rënduese:

- Identifikohen burimet e mbështetjes psiko-sociale që mund të ndihmojnë familjen dhe fëmijën, përfshirë mundësitë për terapi, këshillim dhe mbështetje nga institucione të tjera.
- Analizohen rrethanat që mund të lehtësojnë ose rëndojnë situatën e fëmijës, siç janë faktorët ekonomikë, shëndetësorë dhe socialë që mund të ndikojnë në mirëqenien e tij.

Procesi i Vlerësimit Pedagogjik komunal

Rreth instrumenteve

Mësimdhënësi/kujdestari i klasës pas periudhës vëzhguese (deri në 3 muaj) duhet të bëjë kërkesë me shkrim dhe të plotësojë formularin e KNF-së **“Formulari i raportimit nga shkolla dhe raporti i monitorimit”(formulari i gjelbër)** dhe të dorëzojë tek drejtori i shkollës që të iniciojë procedurën për vlerësim pedagogjik. Drejtori i shkollës pastaj inicion procesin në DKA për t’u proceduar te Ekipi Komunal për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore.

Ekipi komunal pranon një kërkesë për vlerësim nga shkolla, në të cilën pranon edhe instrumentin e KNF-së të plotësuar nga shkolla, respektivisht mësimdhënësi, së bashku me familjarët dhe pjesën tjetër të shkollës.

Pas vlerësimit shkolla pranon instrumentin **“Profili i funksionimit të fëmijës dhe rekomandime vepruese për shkollën dhe familjen” (Formularin e kuq)** me rekomandime dhe këshilla nga Komisioni komuna për Vlerësim Pedagogjik të nxënësve.

Për çfarë shërbejnë këta formularë?

Ky formular i shërben shkollës për të informuar dhe raportuar tek Ekipi Vlerësues në nivel komunal rreth funksionimit të fëmijës/nxënësit në kontekstin shkollor, bazuar në vështirësitë e hasura, veprimet e ndërmarra nga shkolla dhe arsyet e mos tejkalimit të vështirësive, ashtu siç pritej. Në këtë rast, shkolla e konsideron të nevojshme përfshirjen e Ekipit Vlerësues Komunal për vlerësimin e funksionimit të fëmijës/nxënësit, me qëllim të përcaktimit të profilit të tij/saj në aspektin bio-psiko-social. Plotësimi i këtij formulari bën të mundur që fëmija/nxënësi të marrë shërbimet e duhura nga komuna dhe nga institucionet e tjera përkatëse.

Kush është përgjegjës për plotësimin e formularit?

Përgjegjës për plotësimin e këtij formulari është mësimdhënësi/kujdestari i klasës, i cili mund të bashkëpunojë me shërbimin psiko - pedagogjik të shkollës (psikologun, pedagogun, mësimdhënësin mbështetës). Ky formular nënshkruhet nga mësimdhënësi/kujdestari i klasës dhe drejtori i shkollës. Prindi me nënshkrimin e tij/saj, pajtohet me vazhdimin e procesit të vlerësimit të fëmijës nga Ekipi Vlerësues në nivel komunal.

Periudha kur fëmija raportohet për vlerësim:

Periudha gjatë të cilës shkolla duhet të raportojë nevojën për vlerësimin e fëmijës/nxënësit nga Ekipi Vlerësues Pedagogjik në nivel komunal, fillon nga fundi i muajit nëntor, pra pasi që mësuesi të ketë vëzhguar sistematikisht fëmijën/nxënësin për rreth tre muaj. Në raste të caktuara (me fëmijë/nxënës që tashmë e kanë një diagnozë dhe/ose vlerësim paraprak) shkolla mund të kërkojë vlerësim apo rivlerësim të fëmijës/nxënësit në periudha të ndryshme

Periudha gjatë të cilës monitorohet fëmija, pas ndërhyrjes didaktike:

Periudha kur zë fill monitorimi, pas ndërhyrjes didaktike, fillon kur shkolla merr rekomandimet nga Ekipi Vlerësues Komunal. Kjo periudhë mund të zgjasë 6 muaj, por jo më shumë se koha kur përfundon viti shkollor.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

**INSTRUMENTET PËR
VLERËSIMIN PEDAGOGJIK
TË FUNKSIONIMIT
TË FËMIJËVE ME NEVOJA
TË VEÇANTA NË KOSOVË**

**Profili i funksionimit të fëmijës
dhe rekomandime vepruese për
shkollën dhe familjen**

Emri dhe mbiemri _____
Shkolla _____
Komuna _____

Pas vlerësimit të fëmijës Ekipi Komunal për Vlerësim Pedagogjik plotëson formularin e KNF-së
“Profili i funksionimit të fëmijës dhe rekomandime vepruese për shkollën dhe familjen”
(Formulari i kuq).



Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

INSTRUMENTET PËR VLERËSIMIN PEDAGOGJIK TË FUNKSIONIMIT TË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË KOSOVË

Formulari i raportimit nga shkolla
dhe raporti i monitorimit

Emri dhe mbiemri
i fëmijës _____

Shkolla _____

Komuna _____

Përmbledhje e Përdorimit të Formularëve dhe Aktivitetet e Ndërlidhura

Formularët për vlerësimin pedagogjik dhe raportimin shërbejnë si mjet thelbësor për të identifikuar, dokumentuar dhe monitoruar funksionimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkollë dhe për të koordinuar mbështetjen nga shkolla, familja dhe institucionet komunale.

Më poshtë jepen detajet mbi përdorimin dhe aktivitetet që lidhen me këta formularë:

1. “Formulari i raportimit nga shkolla dhe raporti i monitorimit” (formulari i gjelbër)

Qëllimi:

- Identifikon vështirësitë e fëmijës në mjedisin shkollor.
- Përmbledh veprimet e ndërmarra nga shkolla dhe arsyet e mos tejkalimit të vështirësive.
- Inicion procesin për përfshirjen e Ekipit Vlerësues Komunal për një vlerësim më të detajuar.

Aktivitetet që lidhen me këtë formular:

- **Vëzhgim sistematik i fëmijës për një periudhë 3-mujore** për të monitoruar progresin dhe për të identifikuar sfidat e vazhdueshme.
- **Mbledhja e të dhënave** nga mësuesit, psikologët dhe stafi tjetër i shkollës për aspektet akademike, sociale dhe emocionale të fëmijës.
- **Dorëzimi i formularit** tek Ekipi Vlerësues Komunal deri në fund të muajit nëntor për fëmijët me nevoja të identifikuar.

2. “Profili i funksionimit të fëmijës dhe rekomandime vepruese për shkollën dhe familjen” (formulari i kuq).

Qëllimi:

- Dokumenton gjendjen bio-psiko-sociale të fëmijës.
- Identifikon aftësitë dhe kufizimet e tij në mjedisin shkollor dhe shoqëror.
- Siguron bazën për krijimin e një Plani Individual të Arsimit - PIA.

Aktivitetet që lidhen me këtë formular:

- Mbledhja e informacionit nga familja dhe shkolla, përfshirë intervista me prindërit, mësuesit dhe vëzhgime të drejtpërdrejta të fëmijës.
- Vlerësime të detajuara për aftësitë njohëse, emocionale, sociale dhe fizike të fëmijës.
- Krijimi i profilit të funksionimit brenda 6 muajve nga marrja e raportit të shkollës.

3. Rekomandimet Vepruese për Shkollën dhe Familjen

Qëllimi:

- Siguron udhëzime të qarta për veprime specifike që duhen ndërmarrë nga shkolla dhe familja për të mbështetur zhvillimin dhe integrimin e fëmijës.

Aktivitetet që lidhen me këtë formular:

- **Zhvillimi i një Plani Individual të Arsimit (PIA)**, bazuar në profilin e funksionimit të fëmijës.
- **Organizimi i takimeve me stafin shkollor dhe familjen** për të diskutuar mbi rekomandimet dhe për të siguruar implementimin e tyre.
- **Monitorimi i progresit të fëmijës** dhe rishikimi i masave të ndërmarra për të përshtatur strategjitë në varësi të nevojave që dalin.

Përdorimi i këtyre formularëve për koordinim

Në nivelin e shkollës:

- Identifikim i hershëm i nevojave dhe dërgimi i rasteve të fëmijëve tek Ekipi Vlerësues Komunal.
- Mbështetje e drejtpërdrejtë për fëmijët përmes metodave dhe materialeve të përshtatura.

Në nivelin komunal:

- Organizimi i takimeve të Ekipit Vlerësues për shqyrtimin e rasteve.
- Krijimi i planit të mbështetjes dhe përcaktimi i shërbimeve që duhen ofruar për secilin fëmijë.
- Raportimi i progresit dhe monitorimi i rezultateve.

Në nivelin familjar:

- Përfshirja e prindërve në procesin e mbështetjes së fëmijës.
- Udhëzime për krijimin e një mjedisi mbështetës në shtëpi dhe përdorimin e strategjive të përshtatshme për zhvillimin e fëmijës.

Struktura e performancës dhe faktorët ndikues:

- **Performanca** përshkruan atë që bën individi në mjedisin aktual dhe përfshirjen në situata jetësore.
- **Lehtësuesit** përmirësojnë funksionimin dhe ulin paaftësinë (produkte, teknologji, marrëdhënie shoqërore, shërbime).
- **Pengesat** kufizojnë funksionimin dhe krijojnë paaftësi (mjedisi fizik, mungesa e mbështetjes).

Vendi i vlerësimit dhe ruajtja e dosjeve të nxënësve

Vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta është një proces i rëndësishëm që kërkon mbështetje të specializuar dhe mbikëqyrje të kujdesshme. Për këtë arsye, është e rëndësishme që vlerësimi dhe ruajtja e dosjeve të fëmijëve të vlerësuar të bëhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.

Dosjet e fëmijëve të vlerësuar duhet të ruhen në dhomat e vlerësimit në nivel komunal

Ky është një hap i domosdoshëm për të siguruar mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm dhe për të mundësuar qasjen e duhur vetëm për personat e autorizuar, sipas rregulloreve të përcaktuara nga Udhëzimi administrativ.

Dhomat e vlerësimit duhet të jenë të ndara nga hapësira e përditshme e punës dhe të pajisura me mjetet dhe pajisjet didaktike të nevojshme për vlerësimin e fëmijëve. Ky ambient i dedikuar është i nevojshëm për të siguruar kushte të përshtatshme për takime dhe konsultime, duke i mundësuar ekipit komunal që të realizojë vlerësime të sakta dhe efektive.

Nëse ndonjë palë është e pakënaqur me vendimin e vlerësimit të komunës, ai/ajo ka të drejtë të parashtojë ankesë në Ministrinë e Arsimit, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave për fëmijët me nevoja të veçanta, brenda një periudhe 30-ditore nga data e marrjes së vendimit. Ky proces i ankesës është një mundësi për të siguruar që të drejtat e fëmijëve janë mbrojtur dhe që vlerësimi të jetë i drejtë dhe i bazuar në nevojat e vërteta të fëmijës.

Raportimet e ekipit vlerësues

Ekipi vlerësues ka një detyrë të rëndësishme në raportimin dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Ky proces i raportimit është i dyfishtë, pasi Ekipi vlerësues emërohet nga organi i vetëqeverisjes lokale, ndërsa metodologjitë dhe rregulloret për punën e tij përcaktohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Kjo do të thotë se Ekipi ka përgjegjësi për përgatitjen e raporteve për komunën, sipas kërkesës, dhe çdo gjashtë muaj për MASHTI-n.

Ekipi komunal për vlerësim duhet të raportojë çdo muaj tek zyrtari i arsimit gjithëpërfshirës për punën e tij. Ky raport është i domosdoshëm për të siguruar që aktivitetet e Ekipit janë të koordinuara dhe të përputhura me udhëzimet dhe kërkesat legislative.

Raporti për MASHTI duhet të përmbajë informacion të detajuar dhe të strukturuar në mënyrë të qartë. Elementët e raportit janë:

- Hyrje: Përmbledhje e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit.
- Përmbajtja e raportit:
 - Të dhëna për numrin e fëmijëve të referuar dhe të vlerësuar.
 - Numri i fëmijëve të vlerësuar sipas niveleve të vështirësisë.
 - Llojet e vështirësive që janë identifikuar gjatë procesit të vlerësimit.
 - Afatet kohore të vlerësimit, për të kontrolluar korrektësinë dhe përputhshmërinë me kalendarët e paracaktuar.
 - Shërbimet e rekomanduara për secilin fëmijë, për të mbështetur zhvillimin e tij të mëtejshëm.
 - Përfundimi: Një analizë përfundimtare mbi ecurinë e procesit dhe propozimet për përmirësim.

Procedurat e vlerësimit pedagogjik

Dorëzimi i kërkesave:

- Kërkesat për vlerësim dorëzohen në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), te zytari për gjithëpërfshirje.
- Zytari procedon lëndën te Ekipi Vlerësues Pedagogjik brenda afatit ligjor.

Caktimi i datës së Vlerësimit:

- Brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, kryetari i komisionit, në bashkëpunim me ekipin, cakton datën dhe kryen të gjitha procedurat e vlerësimit.
- Në rastet me shumë kërkesa, prioritetet përcaktohen bazuar në rëndësinë e rasteve.

Pjesëmarrja e prindërve:

- Prindërit duhet të marrin pjesë në takimet e ekipit vlerësues.
- Nëse, për arsye objektive apo subjektive, nuk mund të marrin pjesë, takimi mund të shtyhet brenda afatit të përcaktuar.

Përgatitja dhe dërgimi i raporteve:

- Ekipi përgatit një raport me rekomandime për shkollën brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit.

- Raporti dërgohet nga zyrtari për gjithëpërfshirje te institucioni përkatës.

Evidentimi i Vendimeve:

- Ekipi mban procesverbal për çdo takim, duke dokumentuar të gjitha arsyeshmëritë dhe vendimet e marra.

Përgjegjësia për Zbatimin e Vendimeve:

- Drejtori i institucionit arsimor ku referohet fëmija është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të ekipit vlerësues.
- DKA, përmes zyrtarit për gjithëpërfshirje, monitoron zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve.

Privatësia dhe Pëlqimi i Prindërve:

- Fëmija nuk mund të vlerësohet ose t'i përpilohet Plani Individual i Arsimit (PIA) pa informimin e detajuar dhe lejen me shkrim të prindit, gjithashtu PIA është dokument konfidencial dhe në të mund të kenë qasje vetëm profesionistët që punojnë më fëmijën.

FORMULARI I:**KËRKESË PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR VLERËSIM PEDAGOGJIK**

Iniciuesi i Kërkesës për Vlerësim <i>(Sqarim: shëno me x)</i>				
Prindi/ Kujdestari ligjor	Institucioni Edukativo Arsimor	Drejtoria Komunale e Arsimit	Qendra për Punë Sociale	Qendra e Mjekësisë Familjare
Të dhënat për fëmijën/nxënësin që referohet				
Emri dhe mbiemri i fëmijës/nxënësit që referohet				
Mosha				
Vendlindja				
Emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit ligjor:				
Adresa kontaktuese e prindit/kujdestarit ligjor <i>(Shënohet numri i telefonit dhe/apo email-i):</i>				
Vendbanimi				
Institucioni edukativo-arsimor ku është fëmija/nxënësi <i>(Plotësohet vetëm nëse fëmija/nxënësi është në institucion edukativo-arsimor):</i>				

Emri dhe mbiemri i iniciuesit të rastit:

Nënshkrimi:

Data e referimit:

Emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit ligjorë:

Nënshkrimi:

Sqarim: Kjo kërkesë plotësohet nga iniciuesi/referuesi i saj, që mund të jetë: prindi apo kujdestari ligjor i fëmijës, drejtori i institucionit edukativo-arsimor ku është i regjistruar fëmija (me kërkesën e kujdestarit të klasës), DKA-zyrtari i arsimit gjithëpërfshirës, Qendra për Punë Sociale, Qendra e Mjekësisë Familjare (Sipas U.A - MASHTI, nr. 16/2017).

Kur rasti referohet për fëmijën/nxënësin që është brenda institucionit edukativo-arsimor, kërkesa duhet të dorëzohet në institucionin përkatës arsimor. Mësimdhënësi/kujdestari i klasës pas periudhës vëzhguese (deri në 3 muaj) duhet të bëjë kërkesë tek drejtori i shkollës të iniciojë procedurën për vlerësim pedagogjik. Drejtori i shkollës inicion procesin përmes Formularit I (Forma e Inicimit të Kërkesës për Vlerësim) duke ia bashkangjitur Formularin II (Forma e Raportimit dhe Monitorimit) të plotësuar nga mësimdhënësi. Të dy këta formularë njëkohësisht dorëzohen në DKA (te zyrtari për gjithëpërfshirje) për t'u proceduar te Ekipi Komunal për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore.

Në rastet kur referimi vjen për fëmijët që janë jashtë institucioneve edukativo-arsimore, kërkesa për inicim të procedurës dorëzohet në DKA te Zyrtari për gjithëpërfshirje, i cili në bashkëpunim me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës dhe institucionin më të afërt edukativo –arsimor (në zonën ku banon fëmija) e sistemojnë fëmijën në atë institucion dhe pas periudhës vëzhguese (deri në 3 muaj) vlerësohet nga Ekipi Komunal Vlerësues sipas procedurave të parapara.

Në rastet kur fëmija ka dokumentacion përcjellës i cili dëshmon që fëmija ka aftësi të kufizuar, atëherë Ekipi për Regjistrimin në Klasë të Parë, e rekomandon vlerësimin para përmbushjes së periudhës vëzhguese 3 mujore.

RAPORT PËR VLERËSIMIN E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Për: Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Divizioni i Arsimit për Fëmijët me Nevoja të Veçanta

Nga: Drejtoria Komunale e Arsimit në _____

Data dhe vendi _____

VLERËSIMI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË PERIUDHËN _____

Zyrtari për arsim gjithëpërfshirës _____

Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit _____